



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, me 12/07/2021

V E N D I M

Nr. 2, datë 12.07.2021

P Ë R

SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 6, DATË 05.04.2019 "PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURAVE DHE NJOFTIMIN E SUBJEKTIT QË E KA VËNË NË LËVIZJE, GJYKATËN E LARTË, PËR TË VLERËSUAR RISHPALLJEN E THIRRJES PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE" DHE PËRDITËSIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË KANDIDATËVE PËR GJYQTAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 67, 68 dhe 113 të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e Vendimit nr. 6, datë 05.04.2019 "Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidatëve".
2. Rifillimin e procesit të shqyrtimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese të z. Luan Hasneziri, z. Arben Braçe dhe z. Sinan Tafaj si dhe përfshirjen e tyre në listën e kandidatëve të tjerë që kanë aplikuar në bazë të njoftimit të datës 03.06.2021 për t'u zgjedhur anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.
3. Konstatimin e heqjes dorë nga kandidimi i z. Klodian Rado, z. Ardian Dvorani dhe z. Mehdi Bici përpara fillimit të procedurave të shqyrtimit të kandidatëve dhe mospërfshirjen e tyre në listën e kandidatëve që i nënshtrohen shqyrtimit nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në rubrikën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Ervin PUPE
Kryetar

Marsida XHA FERLLARI
Anëtar

Elsa TOSKA
Anëtar

Adnan XHOLI
Anëtar

Astrit KALAJA
Anëtar

Elona TORO
Anëtar

Gjon FUSHA
Anëtar

Rilinda SELIMI
Anëtar

Genti XHOLI
Anëtar